



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR SHQYRTIMIN E RAPORTIT TË NDËRMJETËM TË MONITORIMIT TË FUSHATËS
ZGJEDHORE PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR PARTIA DREJTËSI INTEGRIM DHE UNITET**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 23.06.2017, me pjesëmarrjen e:

Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Gëzim	VELESHNJA	Anëtar
Hysen	OSMANAJ	Anëtar
Vera	SHTJEFNI	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Shqyrtimin e raportit të ndërmjetëm të monitorimit të fushatës zgjedhore për subjektin zgjedhor Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa a dhe neni 24/2, pika 5 i ligjit nr.8580, datë 17.02.2017 "Për partitë politike" i ndryshuar, me ligjin 90/2017, Udhëzimi i KQZ-së nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore".

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N

Ligji nr. 8580 date 17.12.200 "Për partitë politike" i ndryshuar me ligjin 90/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8580 date 17.12.200 "Për partitë politike" si dhe udhëzimi KQZ nr. 1 datë 31.05.2017, "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore", parashikon se gjatë periudhës së fushatës zgjedhore lejohet përdorimi dhe afishimi i materialeve propagandistike zgjedhore statike, përfshirë flamuj dhe postera në një distancë jo më të madhe se 5 metra larg zyrës elektorale të subjektit zgjedhor. Përdorimi i materialeve propagandistike statike, jashtë parashikimit të fjalisë së dytë të kësaj pike është i ndaluar.



Nr. 493 i Vendimit Data 23.06.2017 e Vendimit Ora 10 : 00 e Vendimit

Shqyrtimin e raportit të ndërmjetëm të monitorimit të fushatës zgjedhore për subjektin zgjedhor
Partia Drejtësi Integri dhe Unitet

KQZ me vendimin nr. 374 date 09.06.2017 ka emëruar ekspertët financiar, për monitorimin e fushatës zgjedhore të partive politike, duke përfshirë aktivitetet, veprimtaritë dhe materialet e përdorura prej tyre gjatë fushatës zgjedhore. Për të kryer monitorimin e fushatës zgjedhore te subjektit politik, PDIU, KQZ ka emëruar ekspertë financiar z. Afrim Suli.

Me raportin e ndërmjetëm të monitorimit të datës 22.06.2017 për subjektin politik PDIU, Eksperti Financiar z. Afrim Suli ka konstatuar se:

- Zyra elektorale në lagjen Dobrovë. Ky ambient ishte lokal, por funksiononte dhe si zyrë elektorale e lagjes. Rreth saj, ishin vendosur 9 flamuj të subjektit dhe 1 poster elektorale, të vendosura brenda distancës së parashikuar.
- Zyra elektorale në lagjen Gjok Doci (Kati i parë). Pranë ambientit ishin të vendosur 5 flamuj të subjektit. Gjithashtu, xhamat e fasadës ishin të veshura me printime adezive elektorale. Materialet publicitare ishin vendosur brenda perimetrit të lejuar.
- Zyra elektorale në lagjen Kamen. Pranë ambientit, ishin vendosur 9 flamuj të subjektit dhe disa postera elektorale. Materialet publicitare ishin vendosur brenda perimetrit të lejuar.
- Selia qendrore e subjektit në lagjen "Nazmi Rushiti" (Kati i dytë). Ky ambient shërben si shtabi kryesor i subjektit. Në fasaden e tij ishin vendosur disa postera të mëdha, të ngjitur në fasadë.
- Zyra elektorale në Melan. Pranë ambientit ishin vendosur 4 flamuj të subjektit dhe disa postera elektorale. Materialet publicitare ishin vendosur brenda perimetrit të lejuar.
- Zyra elektorale në Maqellarë (Kati i dytë). Në fasadën e tij, ambienti zotëronte një poster të madh. Materialet publicitare ishin vendosur brenda perimetrit të lejuar.

Në të gjitha zyrat e inspektuara më sipër është ndjekur procedura standarde, prezantimi si ekspert financiar, prezantimi i detyrimeve ligjore dhe kërkimi i lejes për të fotografuar ambientet e jashtme, e cila përbën provën e vetme të inspektimit.

- Gjatë kërkimit të zyrave elektorale, u evidentu një tabelë e madhe elektorale e subjektit PDIU, pranë Bashkisë Dibër, ngjitur me rrethrotullimin. Kjo tabelë e madhe ishte e vendosur mbi një biznes privat dhe nuk kishte lidhje me zyrat elektorale të subjektit. Vendosja e tabelës, sipas nenit 2, të udhëzimit të KQZ-së është i ndaluar.

Nga shqyrtimi i raportit të ndërmjetëm për subjektin politik PDIU të datës 22.06.2017 në territorin e Bashkisë Dibër, rezulton se ky subjekt ka afishuar materiale propagandistike në kundërshtim me nenin 24/2, pika 5 të ligjit 90/2017, në një distancë më larg se 5 metra nga zyrat elektorale.

Referuar nenit 5 të udhëzimit nr. 1, datë 31.07.2017, të KQZ-së, KQZ-ja kur vihet në dijeni, për shkelje të këtij udhëzimi nga ana e subjektit zgjedhor, urdhëron Kryetarin e Bashkisë, për heqjen e materialeve të afishuara në kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe udhëzimit.



Nr. 493 i Vendimit Data 23.06.2017 e Vendimit Ora 10 : 00 e Vendimit

Shqyrtimin e raportit të ndërmjetëm të monitorimit të fushatës zgjedhore për subjektin zgjedhor Partia Drejtësi Integri dhe Unitet

PËR KËTË ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa, a Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe neni 24/2, pika 5 i ligjit nr.8580, datë 17.02.2017 "Për partitë politike" i ndryshuar, me ligjin 90/2017, Udhëzimi i KQZ-së nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore".

V E N D O S I:

1. Të urdhëroj kryetarin e Bashkisë Dibër, për heqjen e tabelës së madhe elektorale të subjektit zgjedhor PDIU, pranë godinës së Bashkisë Dibër, ngjitur me rrethrotullimin, si dhe cdo material tjetër propagandistike të afishuar në kundërshtim me ligjin.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI -	Anëtar
Gëzim	VELESHNJA -	Anëtare
Hysen	OSMANAJ -	Anëtar
Vera	SHTJEFNI-	Anëtare



Nr. 493 i Vendimit Data 23.06.2017 e Vendimit Ora 10 : 00 e Vendimit

Shqyrtimin e raportit të ndërmjetëm të monitorimit të fushatës zgjedhore për subjektin zgjedhor Partia Drejtësi Integri dhe Unitet